



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



ZGJEDHJET LOKALE 2013

ZGJEDH, DUKE VOTUAR!

PERIUDHA E KUNDËRSHTIMIT DHE KONFIRMIMIT TË LISTËS SË VOTUESVE

Periudha e Kundërshtimit dhe Konfirmimit është periudha gjatë së cilës Lista e Votuesve do të bëhet publike për Kundërshtim dhe Konfirmim. Kjo do të ju mundësojë votuesve të regjistruar që të sfidojnë Listën e Votuesve për Zgjedhjet për Kuvendet Komunale dhe për Kryetar të Komunave.

Të interesuarit mund të shikojnë Listën e Votuesve në Zyrën e Komisionit Komunal të Zgjedhjeve çdo ditë pune, deri më 24 shtator 2013.

Çdo votues me të drejtë vote në Kosovë ka të drejtë që të shikojë Listën e Votuesve dhe ta informoj zyrtarin ekzekutiv të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve për çfarëdo lëshimi apo parregullsie.

Verifikoni emrin tuaj, verifikoni emrin e atyre që i njihni dhe sigurohuni se të gjithë janë të përfshirë në Listën e Votuesve!

Që të mund të keni qasje në listën e votuesve, ju duhet të tregoni para zyrtarit ekzekutiv të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve në komunën e juaj një dokument valid identifikimi: letërnjoftimin valid, dokumentin e udhëtimit apo patentë shoferin valid.

Ju mund t'i adresoni Gjykatës së shkallës së parë një parashtrësë, me të cilën kërkonit përjashtimin apo përfshirjen e ndonjë emri në Listën e Votuesve. Ju duhet t'i parashtroni qartë faktet dhe të ofroni çfarëdo dëshmie që mbështet pohimin tuaj.